



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 24
8 qershor – 14 qershor 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	10 / 12	83%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

		Pukë	11 / 11	100%
	Kukës	Kukës	12 / 14	86%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	8 / 9	89%
		Lezhë	Lezhë	10 / 10
	Kurbin		5 / 5	100%
	Mirditë		5 / 6	83%
VLORË	Vlorë	Vlorë	22 / 22	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	423 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 24

	JAVA 23
Diarre pa gjak	1785
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	6423
Infeksione respiratore të poshtme	2381
Rash me temperaturë	26
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	423
% e Njësive Raportuese	99% (423/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Tiranë – 10 raste

Fier– 6 raste



Vlorë – 7 raste

Mat – 2 raste

Mat – 1 rast


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 24 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 23.



Grafiku 3. Trendi në kohë i diarreve pa gjak sipas javëve.**Grafiku 4. Shpërndarja e diarreve pa gjak sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 24 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 23.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 24 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 24 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).**Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 23/2026 dhe 24/ 2026. Incidenca (raste/10.000).**


Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 5-23 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 24 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i ulët i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 23-24/2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Has, Shkodër dhe Vlorë ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda – 2026

- Në Republikën Demokratike të Kongos (provincat Ituri, Kivu i Veriut dhe Kivu i Jugut) janë raportuar gjithsej 676 raste të konfirmuara, përfshirë 136 vdekje të konfirmuara (një rritje prej 41 raste të reja dhe 9 vdekje të reja krahasuar me raportin e mëparshëm). Në Ugandë janë raportuar gjithsej 19 raste të konfirmuara, përfshirë 2 vdekje.
- Më 17 maj 2026, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli se shpërthimi i sëmundjes Ebola i shkaktuar nga virusi Bundibugyo përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC). Më 18 maj 2026, Africa Centres for Disease Control and Prevention e shpalli situatën një Emergjencë të Shëndetit Publik me rëndësi për sigurinë kontinentale.
- Bazuar në informacionin aktual dhe pasiguritë që lidhen me zhvillimin e këtij shpërthimi, mundësia e infektimit për qytetarët e Bashkimit Evropian/Hapësirës Ekonomike Evropiane që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet e ulët. Për personat që jetojnë në BE/EEA, rreziku i infektimit vlerësohet shumë i ulët, duke marrë parasysh mundësinë shumë të ulët të importimit të rasteve dhe transmetimit dytësor.
- European Centre for Disease Prevention and Control po monitoron situatën përmes aktiviteteve të inteligjencës epidemiologjike, dhe po bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e informacionit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut.

Shpërthimi i sëmundjes nga Hantavirusi në një anije turistike – Atlantiku Jugor – 2026

- Deri më 11 qershor 2026, janë raportuar gjithsej 13 raste me infeksion nga virusi Andes (ANDV), përfshirë 12 raste të konfirmuara dhe 1 rast të mundshëm (probable). Që nga përditësimi i mëparshëm nuk janë raportuar vdekje të reja.
- Zbritja dhe evakuimi i pasagjerëve dhe ekuipazhit nga anija turistike M/V Hondius u realizua në Tenerife, Ishujt Kanarie, gjatë periudhës 10–11 maj, si dhe në Rotterdam, Holandë, më 18 maj 2026.
- Analiza e sekuencimit gjenomik nga disa prej rasteve pozitive konfirmoi një ngjashmëri të lartë gjenetike midis izolateve virale, duke sugjeruar një ngjarje fillestare të transmetimit zoonotik (kalimi i virusit nga kafshët te njerëzit), e ndjekur më pas nga transmetimi person-person.
- Rreziku për popullatën e përgjithshme në Bashkimin Evropian/Hapësirën Ekonomike Evropiane (BE/EEA) nga përhapja e virusit Andes në lidhje me këtë shpërthim në anijen turistike mbetet shumë i ulët.

Fruthi – Monitorimi i shpërthimeve në Evropë

Në prill 2026, 29 vende të Bashkimit Evropian/Hapësirës Ekonomike Evropiane (BE/EEA) raportuan të dhëna për fruthin. Shtatëmbëdhjetë vende raportuan gjithsej 451 raste, ndërsa 12 vende nuk raportuan asnjë rast.

- Gjatë periudhës së mëparshme 12-mujore, në European Centre for Disease Prevention and Control janë raportuar tri vdekje të lidhura me fruthin, përkatësisht nga Franca (2 raste) dhe Holanda (1 rast).
- Në përgjithësi, numri i rasteve të fruthit është rritur krahasuar me muajin e mëparshëm.
- Më 11 qershor 2026 u krye monitorim plotësues përmes aktiviteteve të survejancës së inteligjencës epidemiologjike. Janë raportuar shpërthime epidemike në Bullgari, ndërsa raste sporadike dhe grupime rastesh (clusters) janë raportuar në disa vende të tjera të BE/EEA.
- Përditësime të situatës epidemiologjike janë dhënë gjithashtu për disa vende dhe rajone jashtë BE/EEA, ku vijon monitorimi i qarkullimit të virusit të fruthit.

Sëmundja nga virusi Chikungunya – Guajana Franceze, Francë – 2026

- Në Guajanën Franceze vijon qarkullimi aktiv i virusit Chikungunya, me 621 raste të raportuara nga 1 janar deri më 31 maj 2026.
- Shtatëdhjetë për qind e rasteve janë konfirmuar në sektorin Littoral Ouest. Më 23 prill 2026, ky sektor u shpall në fazën “epidemike” të shpërthimit.
- Sektorët Savanes dhe Ile de Cayenne aktualisht ndodhen në fazën e “grumbullimeve të rasteve (outbreak clusters)”.
- Mundësia aktuale e infektimit me virusin Chikungunya për udhëtarët që vizitojnë Guajanën franceze vlerësohet e ulët. Gjithashtu, mundësia e transmetimit të mëtejshëm në Evropën kontinentale pas importimit të virusit nga një udhëtar në fazën e viremisë (me virus në gjak) konsiderohet e ulët.
- Udhëtarëve u rekomandohet të zbatojnë masa të përforcuara për mbrojtjen nga pickimet e mushkonjave, përfshirë përdorimin e repelentëve, veshjeve mbrojtëse dhe masa për shmangien e ekspozimit ndaj vektorëve. Vaksinimi mund të merret në konsideratë sipas rekomandimeve kombëtare.

Sëmundja nga virusi Nipah – India dhe Bangladesh – 2026

- Më 10 qershor 2026, në distriktin Kozhikode, Kerala, Indi, u raportua një rast i virusit Nipah (NiV) në një person rreth të dyzetave me encefalit. Rasti rezultoi pozitiv për NiV, ndërsa rezultatet konfirmuese janë ende në pritje.
- Pacienti është i shtruar në spital dhe ndodhet në gjendje të qëndrueshme. Infeksioni dyshohet të jetë marrë gjatë pastrimit të një magazine, megjithëse burimi i saktë i ekspozimit nuk është konfirmuar.
- Janë identifikuar gjithsej 77 kontakte, ku kontaktet me rrezik të lartë janë vendosur në karantinë. Deri tani nuk janë raportuar raste dytësore.
- Rastet e mëparshme përfshijnë:
 - Bangladesh një vdekje në Rajshahi Division më 6 shkurt 2026.
 - Indi dy raste në West Bengal më 26 janar 2026.
- Vlerësimi aktual i rrezikut tregon se mundësia e ekspozimit dhe infeksionit me virusin Nipah për banorët ose udhëtarët e BE/EEA që shkojnë në Indi ose Bangladesh është shumë e ulët, duke pasur parasysh numrin e ulët të rasteve në zonat e prekura.